

FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË PUNËS

I

TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS

Emërtesa e pozicionit: Drejtor i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ

Institucioni: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Drejtoria: Drejtoria e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ

Raporton tek: Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion

II

MISIONI

Misioni i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ është hartimi i analizave të riskut dhe kryerja e hetimeve administrative në institucione publike me qëllim mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në realizimin e misionit të saj, për të siguruar parandalimin e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore/entet publike/shoqëritë tregtare me kapital shtetëror.

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ përgjigjet tek Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion për kryerjen e analizës dhe vlerësimit të riskut për korrupsion, për trajtimin e ankesave dhe denoncimeve të paraqitura pranë drejtorisë së përgjithshme, për realizimin e planeve të hetimit dhe kryerjen e kontrollit dhe hetimit administrativ në institucionet ku shtrin veprimtarinë drejtoria e përgjithshme.

IV

DETYRAT KRYESORE

- a) Ndjek dhe raporton tek drejtori i përgjithshëm mbi veprimtarinë e drejtorisë që mbulon;
- b) Ndjek procesin e hartimit të analizave të riskut;
- c) Drejton dhe organizon punën për identifikimin e problematikave duke i rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm, rastet për të cilat kërkohet një hetim i thelluar në ndihmë të Koordinatorit kundër Korrupsionit apo kryerjen e verifikimeve tematike/planeve të hetimit në institucionet ku shtrin veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit;
- ç) Identifikon problematika dhe rekomandon masa për përmirësimin e veprimtarisë së drejtorisë që drejton, duke rekomanduar standardizimin e praktikave të ndjekura nga kjo drejtori dhe nga Koordinatorët kundër Korrupsionit dhe i bën prezent ato tek drejtori i përgjithshëm;
- d) Ndjek realizimin e detyrave funksionale të nëpunësve të kësaj drejtorie dhe koordinatorëve dhe kryen vlerësimin gjashtëmujor të tyre;

dh) Mbikëqyr bashkëpunimin e Koordinatorëve kundër Korrupsionit me nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;

e) Garanton realizimin e masave dhe rekomandimeve të propozuara institucionit përkatës nga raportet përfundimtare, ekzekutimin e masave disiplinore dhe raporton pranë eprorëve sa herë kërkohet dhe jo më pak se dy herë në vit.

V

PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. Planifikimin dhe Objektivat (nëse ka)

A.1. Drejton dhe organizon punën e Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ;

A.2. Garanton verifikimin dhe hetimin administrativ të ankesave dhe denoncimeve të paraqitura pranë drejtorisë së përgjithshme;

A.3. Monitoron zbatimin e masave dhe rekomandimeve të dhëna ndaj institucioneve ku shtrin veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit;

A.4. Garanton përgatitjen dhe përditësimin periodik të informacionit lidhur me fushën në përputhje me planin e punës, misionin dhe objektivat e drejtorisë.

B. Menaxhimin (nëse ka)

B.1. Koordinon punën e drejtorisë me qëllim që të sigurohet cilësia dhe realizimi në kohë i rezultateve lidhur me objektivat e planifikuara;

B.2. Menaxhon punën në drejtori duke shfrytëzuar burimet për arritjen e objektivave me efektivitet dhe efikasitet;

B.3. Menaxhon stafin në varësi nëpërmjet vendosjes së objektivave, matjes së performancës së tyre nëpërmjet vlerësimit të punës, si dhe duke përcaktuar fushat në të cilat janë të nevojshme të bëhen përmirësime;

B.4. Deleton detyra dhe siguron vazhdueshmëri në përmbushjen e tyre duke u kujdesur për angazhimin maksimal të nëpunësve të drejtorisë;

B.5. Mban lidhje direkt me Drejtorin e Përgjithshëm për realizimin e detyrave të ngarkuara;

B.6. Ndërmerr veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës, në strukturën që drejton.

C. Detyrat Teknike

C.1. Drejton, organizon dhe koordinon veprimtarinë e Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ, si dhe të koordinatorëve;

C.2. Siguron përgatitjen e materialeve të duhura për drejtorinë në mënyrë që të arrihen qëllimet, objektivat, si dhe detyrat kryesore të drejtorisë;

C.3. Merr pjesë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në luftën kundër korrupsionit;

C.4. Analizon dhe merr pjesë në përgatitjen e raportit të performancës së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;

C.5. Akseson sistemin elektronik të menaxhimit të denoncimeve për rekordet korruptive dhe sigurohet që në sistem të ngarkohet çdo dokumentacion ose shkresë shtesë që lidhet me çdo ankesë/rast.

D. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin

D.1. Përfaqëson drejtorinë e përgjithshme në grupe pune, me miratim të drejtorit të përgjithshëm;

D.2. Bashkërendon punën brenda drejtorisë përkatëse, si dhe siguron bashkëpunimin e nëpunësve të drejtorisë me koordinatorët kundër korrupsionit;

D.3. Mban lidhje me institucionet ku shtrin veprimtarinë drejtorie e përgjithshme, me qëllim që të zgjidhë problematikat dhe të sigurojë funksionimin e efektshëm të detyrave nga ana e koordinatorëve kundër korrupsionit.

VI

Zgjidhja e Problemeve

Zgjidh probleme të ndryshme të fushës së drejtorisë/institucionit, që ndikojnë në arritjen e objektivave të drejtorisë.

VII. Vendimmarrja

Konstante, në përputhje me aktivitetin e drejtorisë.

VIII. Mjedisi Menaxherial

Raporton dhe përgjigjet direkt tek drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme ose titullari i institucionit. Puna në këtë pozicion ndikon në një pjesë të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme ose të Institucionit.

IX.

MBIKËQYRJA

Drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ merr udhëzime specifike dhe të përgjithshme nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

X.

STAFI NËN VARËSI

Drejtori i Drejtorisë ka në varësi të drejtpërdrejtë 2 Përgjegjës Sektori dhe 9 specialistë.

XI

KUSHTET E PUNËS

Realizon objektivat e pozicionit të punës në kushte të përshtatshme dhe optimale, të cilat garantojnë produktivitetin dhe realizimin e qëllimit të tij institucional. Kur është e domosdoshme mund t'i kërkojë jashtë orarit zyrtar për realizimin e detyrave urgjente.

XII

KËRKESAT E POSAÇME

(arsim/përvoja në punë /të tjera për kategorinë/klasën /grupin)

Arsimi: Të ketë diplomë të nivelit Master Shkencor apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në Shkenca Juridike/Ekonomike. Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë.

Përvoja: Të ketë 3 vite përvojë pune në profesion.

Tjetër: Njohuri dhe aftësi mbi: (i) Legjislacionin sipas veprimtarisë që mbulon drejtorja: të vendimit nr. 29, datë 17.1.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”, vendimit nr. 436, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”; Ligj Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Ligj Nr. 111/2018 “Për kadastrën”; Ligj Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligj Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligj Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (ii) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurave Administrative.

Aftësi për të: (i) aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, (ii) aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, (iii) për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, (iv) aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

XIII

NËNSHKRIMI

Nëpunësi civil:.....Firma:

Eprori direkt:.....Firma:

Drejtore i Përgjithshëm:.....Firma:

FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË PUNËS

I

TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS

Emërtesa e pozicionit: Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit

Institucioni: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Drejtoria: Drejtoria e Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit

Raporton tek: Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

II

MISIONI

Misioni i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit është të garantojë hartimin e kuadrit të politikave parandaluese antikorrupsion, të sigurojë implementimin e dokumentave strategjikë në fushën kundër korrupsionit, si dhe të sigurojë bashkëpunimin me organizata ndërkombëtare në fushën antikorrupsion.

III

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Drejtori i drejtorisë së Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit përgjigjet tek drejtori i përgjithshëm për procesin e hartimit/rishikimit dhe monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit, procesin e hartimit/rishikimit dhe monitorimit të Planeve të Integritetit, procesin e hartimit dhe zbatimit të Planit vjetor të Komunikimit dhe Vizibilitetit në Fushën Antikorrupsion, realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit me partnerë kombëtarë ose ndërkombëtare, si dhe për garantimin e transparencës së veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

IV

DETYRAT KRYESORE

- a) Drejton procesin e hartimit/rishikimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit;
- b) Ndjek procesin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit;
- c) Drejton procesin e hartimit/rishikimit dhe monitorimit të Planeve të Integritetit;
- ç) Drejton procesin e hartimit dhe zbatimit të Planit vjetor të Komunikimit dhe Vizibilitetit në Fushën Antikorrupsion;

- d) Drejton proceset e punës për zhvillimin e iniciativave dhe veprimtarive në fushën e politikave parandaluese antikorruption;
- dh) Përgjigjet për bashkërendimin e punës me drejtoritë e tjera brenda drejtorisë së përgjithshme dhe me institucionet, të cilat janë të përfshira në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit;
- e) Menaxhon punën e drejtorisë për zhvillimin dhe hartimin e dokumenteve të politikës në fushën antikorruption;
- ë) Kujdeset që veprimtaria e drejtorisë të jetë e hapur dhe transparente për bashkëpunëtorët dhe publikun;
- f) Raporton pranë drejtorit të përgjithshëm lidhur me detyrat e ngarkuara dhe përmbushjen e tyre.

V

PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. Planifikimin dhe Objektivat (nëse ka)

- A.1. Drejton dhe organizon punën e Drejtorisë së Politikave në Fushën e Antikorruptionit;
- A.2. Garanton hartimin e kuadrit të politikave parandaluese antikorruption si dhe siguron implementimin e tyre;
- A.3. Garanton përgatitjen dhe përditësimin periodik të informacionit lidhur me fushën në përputhje me planin e punës, misionin dhe objektivat e drejtorisë;
- A.4. Siguron planifikimin dhe realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

B. Menaxhimin (nëse ka)

- B.1. Koordinon punën e drejtorisë me qëllim që të sigurohet cilësia, realizimi në kohë i rezultateve lidhur me objektivat e planifikuara;
- B.2. Menaxhon punën në drejtori duke shfrytëzuar burimet për arritjen e objektivave me efektivitet dhe efikasitet;
- B.3. Koordinon punën me drejtoritë e tjera brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorruptionit me qëllim dakordësimin dhe mbarëvajtjen e punës;
- B.4. Përgjigjet për disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës të nëpunësve të drejtorisë dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.
- B.4. Mbikëqyr punën e drejtorisë dhe merr pjesë në vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve.

C. Detyrat Teknike

- C.1. Prezanton raportet e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit në takimet teknike që zhvillohen për këtë qëllim;
- C.2. Zhvillon takimet informuese dhe fushatat e ndërgjegjësimit që zhvillohen me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- C.3. Zhvillon takimet informuese me institucione publike, në kuadër të gjetjeve dhe rekomandimeve që janë dhënë për Shqipërinë në raportet e publikuara nga organizmat

ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit (UNCAC, Transparency International, GRECO etj);

C.4. Rishikon draftet finale të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet shqiptare dhe ndërkombëtare, si dhe organizatat vendore, rajonale e ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe ja përcjell për miratim drejtorit të përgjithshëm;

C.5 Drejton sekretariatit teknik të Ekipit Tematik Antikorrupsion, me miratim të drejtorit të përgjithshëm.

D. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin

D.1. Përfaqëson në marrëdhënie bashkëpunimi me organizata të huaja, ndërkombëtare dhe rajonale të fushës në funksion të ushtrimit të përgjegjësisë së tij, me miratim të drejtorit të përgjithshëm;

D.2. Bashkërendon punën e drejtorisë me drejtorin të tjerë brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, si dhe me strukturat jashtë institucionit;

D.3. Bashkërendon punën dhe mbikëqyr realizimin e bashkëpunimit të nëpunësve në varësi të tij me kolegët brenda drejtorisë dhe me ata të drejtorisë së përgjithshme;

D.4. Bashkëpunon dhe koordinon aktivitete me institucione të huaja (partnerë) lidhur me çështje të zhvillimit dhe realizimit të instrumenteve të politikave në fushën antikorrupsion;

VI

Zgjidhja e Problemeve

Zgjidh probleme të ndryshme të fushës së drejtorisë /institucionit, që ndikojnë në arritjen e objektivave të drejtorisë.

VII. Vendimmarrja

Konstante, në përputhje me aktivitetin e drejtorisë.

VIII. Mjedisi Menaxherial

Raporton dhe përgjigjet direkt tek drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme ose titullari i institucionit. Puna në këtë pozicion ndikon në një pjesë të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme ose të Institucionit.

IX.

MBIKËQYRJA

Drejtori i Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit merr udhëzime specifike dhe të përgjithshme nga drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

X.

STAFI NËN VARËSI

Drejtori i Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit ka në varësi të drejtpërdrejtë 2 përgjegjës sektori dhe 6 Specialistë.

XI

KUSHTET E PUNËS

Realizon objektivat e pozicionit të punës në kushte të përshtatshme dhe optimale, të cilat garantojnë produktivitetin dhe realizimin e qëllimit të tij institucional. Kur është e domosdoshme mund t'i kërkojë të qëndrojë jashtë orarit zyrtar për realizimin e detyrave urgjente.

XII

KËRKESAT E POSAÇME

(arsim/përvoja në punë /të tjera për kategorinë/klasën /grupin)

Arsimi: Të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në Shkenca Juridike/Sociale/Politike/Marrëdhënie ndërkombëtare. Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë.

Përvoja: Të ketë 3 vite përvojë pune në profesion.

Tjetër: Njohuri dhe aftësi mbi: (i) Legjislacionin sipas veprimtarisë që mbulon drejtorinë: të vendimit nr. 29, datë 17.01.2024, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”, të vendimit nr. 436, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”, (ii) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative; (iii) Metodat kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike. (iv) Njohuri mbi Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, (v) Njohuri mbi organizatat ndërkombëtare në fushën e antikorrupsionit dhe raportet kryesore që prodhohen prej tyre, (vi) Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe përdorimin e programeve kompjuterike.

Aftësi për të: (i) aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, (ii) aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, (iii) për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, (iv) aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

XIII

NËNSHKRIMI

Nëpunësi civil:.....Firma:

Eprori direkt:.....Firma:

Drejtore i Përgjithshëm:.....Firma:

FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË PUNËS

I

TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS

Emërtesa e pozicionit: Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Monitorimit të Zbatimit të Rekomandimeve

Institucioni: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Drejtoria: Drejtoria e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ

Sektori: Sektori i Analizës dhe Monitorimit të Zbatimit të Rekomandimeve

Raporton tek: Drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ

II

MISIONI

Misioni i Sektorit të Analizës dhe Monitorimit të Zbatimit të Rekomandimeve është kryerja e analizave të riskut në institucione publike me qëllim mbështetjen e Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ në përmbushjen e objektivave të saj, në kuadër të parandalimit të korrupsionit në administratën publike, si dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna ndaj institucioneve ku shtrin veprimtarinë drejtoria e përgjithshme, duke synuar rritjen e performancës së këtyre institucioneve në ofrimin e shërbimeve publike.

III

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Përgjegjësi i Sektorit të Analizës dhe Monitorimit të Zbatimit të Rekomandimeve përgjigjet tek Drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ për hartimin dhe vlerësimin e analizave të riskut për korrupsion, për realizimin e masave dhe rekomandimeve të propozuara ndaj institucioneve, që synojnë ndërgjegjësimin e punonjësve pranë këtyre institucioneve në parandalimin e korrupsionit në administratën publike.

IV

DETYRAT KRYESORE

- a) Vlerëson dhe harton analiza mbi proceset apo sektorët me risk të lartë në institucionet ku shtrin veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit;
- b) Vlerëson dhe harton raporte të veçanta ose dokumente mbi analizën e riskut për secilin institucion, ku shtrin veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit;
- c) Vlerëson dhe harton raporte periodike mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;

ç) Siguron ndjekjen e zbatimit të masave dhe rekomandimeve të propozuara institucionit përkatës nga raportet përfundimtare, ekzekutimin e masave disiplinore dhe raporton pranë eprorëve sa herë kërkohet dhe jo më pak se dy herë në vit;

d) Ndjek ecurinë e proceseve gjyqësore, ku Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është palë.

V

PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. Planifikimin dhe Objektivat (nëse ka)

A.1. Planifikon organizimin e punës, me qëllim sigurimin në kohë dhe cilësi të objektivave të miratuara;

A.2. Planifikon ndjekjen e gjyqeve, ku është palë Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit;

A.3. Mbikëqyr zbatimin e masave dhe rekomandimeve të dhëna ndaj institucioneve ku shtrin veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

B. Menaxhimin (nëse ka)

B.1. Bën shpërndarjen e detyrave dhe praktikave, në përputhje me përgjegjësitë dhe ngarkesën e çdo specialisti dhe siguron që secili i ka të qarta detyrat dhe objektivat e përcaktuara. Menaxhon punën në sektor duke shfrytëzuar burimet për arritjen e objektivave me efektivitet dhe efikasitet;

B.2. Menaxhon marrëdhëniet e punës me kolegët e të njëjtin nivel dhe vartësit e tij;

B.3. Monitoron punën e sektorit dhe merr pjesë në vlerësimin e rezultateve në punë të specialistëve të sektorit.

B.4. Përgjigjet për disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës të specialistëve të sektorit dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

C. Detyrat Teknike

C.1. Përgjigjet për hartimin e analizave të riskut për korrupsion mbi sektorët dhe fushat që mbulojnë institucionet, ku shtrin veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit;

C.2. Përgjigjet për informacionet periodike që kërkohen nga eprorët;

C.3. Merr pjesë në grupe pune, të ngritura me urdhër të drejtorit të përgjithshëm dhe kontribuon sipas fushës së ekspertizës në përmbushjen e detyrave të caktuara në urdhër;

C.4. Përfaqëson në gjykatë Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, përgatit mbrojtjen dhe dorëzon pranë Gjykatës apo Prokurorisë çdo dokumentacion që kërkohet lidhur me rastin.

C.5. Akseson sistemin elektronik të menaxhimit të denoncimeve për rekordet korruptive dhe sigurohet që të ngarkojë në sistem çdo dokumentacion ose shkresë shtesë që lidhet me ankesat/rastet e deleguara nga eprorët;

C.6. Përfaqëson në gjykatë Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit për çështjet ku drejtoria e përgjithshme është palë, me autorizim të drejtorit të përgjithshëm.

D. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin

D.1. Përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme në grupe pune, me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm;

D.2. Bashkërendon punën dhe mbikëqyr realizimin e bashkëpunimit midis specialistëve në vartësi të tij me kolegët brenda drejtorisë, dhe me ata të drejtorisë së përgjithshme.

D.3. Ndihmon në vendosjen e bashkëpunimit midis specialistëve të sektorit me koordinatorët kundër korrupsionit dhe zgjidh mosmarrëveshjet e krijuara mes tyre, me qëllim mbarëvajtjen e punës.

VI

Zgjidhja e Problemeve

Zgjidh probleme lidhur me aktivitetet e përditshme që ndikojnë në arritjen e rezultateve faktike të sektorit.

VII. Vendimmarrja

Konstante, në përputhje me kuadrin ligjor, procedurat dhe standardet.

VIII. Mjedisi Menaxherial

Përgjegjësi i Sektorit të Analizës dhe Monitorimit të Zbatimit të Rekomandimeve raporton dhe përgjigjet direkt tek Drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ, i cili vendos mbi çështjet procedurale të lidhura me veprimtarinë e sektorit. Puna në këtë pozicion ndikon në veprimtarinë e drejtorisë përkatëse.

IX.

MBIKËQYRJA

Përgjegjësi i Sektorit të Analizës dhe Monitorimit të Zbatimit të Rekomandimeve merr udhëzime specifike nga drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ dhe udhëzime të përgjithshme nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

X.

STAFI NËN VARËSI

Përgjegjësi i sektorit ka në varësi të drejtpërdrejtë 3 specialistë.

XI

KUSHTET E PUNËS

Realizon objektivat e pozicionit të punës në kushte të përshtatshme dhe optimale, të cilat garantojnë produktivitetin dhe realizimin e qëllimit të tij institucional. Kur është e domosdoshme mund t'i kërkojë jashtë orarit zyrtar për realizimin e detyrave urgjente.

XII

KËRKESAT E POSAÇME

(arsim/përvoja në punë /të tjera për kategorinë/klasën /grupin)

Arsimi: Të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në Shkenca Juridike/Ekonomike. Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë.

Përvoja: Të ketë 2 vite përvojë pune në profesion.

Tjetër: Njohuri dhe aftësi mbi: (i) Legjislacionin sipas veprimtarisë që mbulon drejtoria: të vendimit nr. 29, datë 17.1.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”, vendimit nr. 436, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”; Ligj Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Ligj Nr. 111/2018 “Për kadastrën”; Ligj Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligj Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligj Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (ii) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurave Administrative;

Aftësi për të: (i) aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, (ii) aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, (iii) për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, (iv) aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga për zgjedhja e tyre.

XIII

NËNSHKRIMI

Nëpunësi civil:.....Firma:

Eprori direkt:.....Firma:

Drejtor i Përgjithshëm:.....Firma:

FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË PUNËS

I

TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS

Emërtesa e pozicionit: Përgjegjësi i sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Institucioni: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Sektori: Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Raporton tek: Drejtori i Përgjithshëm

II

MISIONI

Menaxhon procesin për: (i) realizimin e mirëadministrimit financiar të fondeve buxhetore të miratuara dhe burimeve të tjera financiare; (ii) për administrimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si dhe (iii) siguron administrimin, ruajtjen dhe redaktimin e komunikimit shkresor të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Përgjegjësi i sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse përgjigjet tek Drejtori i Përgjithshëm për: (i) koordinimin, zbatimin e procedurave të lidhura me veprimet që gjenerojnë shpenzime dhe/ose të ardhura; (ii) menaxhimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme; (iii) menaxhimin, administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit që hyn dhe prodhohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.

IV

DETYRAT KRYESORE

- a) Zbaton dhe koordinon buxhetin vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe të gjitha aktet administrative me efekt financiar, duke garantuar përputhshmërinë me ligjin;
- b) Regjistron të ardhurat dhe shpenzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në sistemet përkatëse sipas zërave në bazë të ligjit, si dhe mban inventarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- c) Kontabilizon dhe koordinon gjendjen e asetëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, si dhe lëvizjet e vlerave monetare dhe materialeve, në përputhje me dokumentacionin përkatës dhe legjislacionin në fuqi;
- ç) Harton, përditëson regjistrin e aktiveve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, si dhe siguron ligjshmërinë e zbatimit të procedurave dhe sistemit kontabël për kryerjen e veprimeve financiare;

- d) Përgatit pasqyrat financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe raporte periodike të sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për të ardhurat dhe shpenzimet dhe çështje të tjera që ka ndjekur sektori dhe ja paraqet eprorit direkt;
- dh) Identifikon, vlerëson dhe kontrollon risqet që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë ku punon, dhe përditëson regjistrin e riskut;
- e) Koordinon veprimtarinë për përgatitjen e raportit vjetor në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet dhe problemet e tjera që ka ndjekur sektori;
- ë) Organizon, koordinon dhe mbikëqyr procesin e planifikimit të nevojave për burime njerëzore në drejtorinë e përgjithshme dhe kualifikimin e tyre;
- f) Udhëzon, koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me rekrutimin, lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë, transferimet e përkohshme dhe të përhershme, pezullimet, lirimimin, vlerësimin e rezultateve në punë, etj.;
- g) Udhëzon, koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me administrimin e dosjeve të personelit dhe sistemit HRMIS;
- gj) Organizon punën për shqyrtimin e listave të vendimit për asgjësimin e dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes;
- h) Mbikëqyr shpërndarjen e shkresave në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive;
- i) Sugjeron për miratim tek drejtori i përgjithshëm vendosjen e objektivave të performancës;
- j) Raporton tek drejtori i përgjithshëm, rregullisht dhe/ose me kërkesë, mbi veprimtarinë financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- k) Harton raporte mbi zbatimin e detyrave të parashikuara në planet periodike të punës të sektorit dhe ia paraqet drejtorit të përgjithshëm;
- l) Harton raporte informimi mbi të drejtat dhe detyrimet financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe rakordon fondet buxhetore në bazë të planifikimit vjetor.
- m) Përgatit raporte periodike bazuar në kontrollin e arkës, për arkëtimet, pagesat, kontabilizimin e veprimeve financiare dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.
- n) Përgatit materiale informuese sipas kërkesës së drejtorit të përgjithshëm, në lidhje me të dhënat e personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- o) Koordinon dhe mbikëqyr procedurat lidhur me hartimin e përshkrimeve të punës;
- p) Raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, si dhe ndjek procedurat përkatëse për vendet e publikuar nga DAP;
- q) Mbikëqyr raportimin periodik mbi lirimet/emërimet/proceset gjyqësore tek DAP;
- r) Mbikëqyr procesin e planifikimit dhe të ndryshimit të grafikut të pushimeve vjetore dhe të lejeve të tjera të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në zbatim të legjisllacionit;
- s) Mbikëqyr dhe jep udhëzime mbi zbatimin e detyrave lidhur me administrimin e sistemit elektronik të regjistrit të personelit HRMIS;
- t) Jep udhëzime për projektpropozimet për ndërtimin e strukturave dhe të organikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, sipas rekomandimeve të eprorëve;
- u) Ndjek dhe kontrollon veprimet e kryera në valutë dhe hedh në ditarin e arkës së valutës të gjitha veprimet e kryera, përlllogarit dietat për shpenzimet jashtë shtetit;
- v) Ndjek realizimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale gjatë periudhës ushtrimore dhe harton raportet periodike përkatëse;
- w) Jep mendim për hartimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit dhe të propozimeve për ndryshim të saj sipas nevojës.

V

PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. Planifikimin dhe objektivat

- A.1. Planifikon aktivitetin ditor dhe javor në mbështetje të detyrave të caktuara për të siguruar realizimin në kohë në mbështetje të objektivave të përcaktuara në planet e sektorit;
- A.2. Përgatit planin e punës për të gjithë sektorin me qëllim që detyrat të jenë gjithëpërfshirëse dhe të zbatueshme në të gjithë punën e sektorit;
- A.3. Përcakton objektiva në kuadër të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë;
- A.4. Planifikon nevojat për rekrutim, trajnim të vazhdueshëm të burimeve njerëzore, për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- A.5. Përcakton objektiva të qarta profesionale për secilin nga anëtarët e stafit dhe harton planin e punës për të gjithë sektorin, me qëllim që detyrat të jenë gjithëpërfshirëse, të zbatueshme dhe të vlerësueshme objektivisht dhe ia paraqet ato për miratim drejtorit të përgjithshëm;
- A.6. Ofron mbështetje për drejtorin e përgjithshëm në interpretimin e propozimeve për praktikatat që lidhen me miradministrimin e burimeve njerëzore;
- A.7. Planifikon hapjen e dosjeve sipas afateve të përcaktuara brenda muajit të parë të çdo viti, në bazë të pasqyrës emërtuese të çeljes së dosjeve;
- A.8. Planifikon mbylljen e dosjeve sipas afateve të përcaktuara brenda 6 mujorit të parë, të çdo viti, në bazë të pasqyrës emërtuese të çeljes së dosjeve.

B. Menaxhimin

- B.1. Shpërndan punën midis specialistëve të sektorit për të siguruar realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave dhe realizimin e objektivave të planifikuara.
- B.2. Monitoron punën e sektorit dhe bën të mundur vlerësimin e aftësive dhe performancën e tyre në punë.
- B.3. Siguron zhvillimin e një sistemi informacioni në kuadër të sektorit në mënyrë që problemet e ndryshme të mund të identifikohen në kohë.
- B.4. Siguron që puna të kryhet brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave, si dhe siguron që detyrat/objektivat të realizohen në përputhje me politikat e institucionit, me standardet administrative dhe procedurat teknike.
- B.5. Përgjigjet për disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës në strukturën që drejton dhe ndërmer veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

C. Detyrat teknike

- C.1. Kontrollon dhe regjistron në sistem dhe praktikatat e hartuara nga drejtoritë e tjera përpara ekzekutimit të urdhër shpenzimit me synim përmbushjen e kërkesave ligjore;
- C.2. Regjistron çdo ditë shpenzimet e realizuara duke i kanalizuar sipas zërave të shpenzimeve dhe rakordon çdo muaj me Degën e Thesarit;
- C.3. Përpilon tabelën përmbledhëse sipas formateve të miratuara nga drejtori i përgjithshëm, për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara, sipas programeve buxhetore;
- C.4. Përllogarit çdo muaj listëpagesat, raportet mjekësore, listat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe dietat dhe honoraret;

- C.5. Kryen regjistrimin dhe deklarimet e nevojshme në sistemin elektronik të tatimeve për të gjithë punonjësit;
- C.6. Plotëson formularët tip të sigurimeve shoqërore mbi kontributet e paguara për ish-punonjësit për efekt llogaritjeje të përfitimit;
- C.7. Lëshon faturat për arkëtim mbi bazën e kërkesës për licenca, leje, certifikime, etj.;
- C.8. Kontrollon magazinën dhe të gjitha lëvizjet e vlerave monetare e materialeve, në përputhje me dokumentacionin përkatës e sipas legjislacionit në fuqi;
- C.9. Realizon arkëtimet dhe pagesat, mbajtjen e kontabilitetit për të gjithë projektet me financim të huaj dhe bashkëfinancim që administrohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- C.10. Pasqyron në sistem angazhimin e fondeve për kontratat e lidhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Antikorrupsionit për kontratat një apo shumë vjeçare;
- C.11. Udhëzon dhe harton materiale për realizimin e procedurave në përputhje me legjislacionin përkatës, në kuadër të pranimit dhe emërimit në shërbimin civil, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele, të ngritjes në detyrë të nëpunësve civilë, etj.;
- C.12. Plotëson të dhënat përkatëse në regjistrin e lëvizjes së personelit dhe librezat e punës për punonjës dhe ish-punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

D. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin

- D.1. Mban marrëdhënie me Kryeministrinë dhe institucione të tjera për monitorimin e fondeve buxhetore, si dhe merr pjesë e kontribuon në aktivitetet e zhvilluara nga ato;
- D.2. Bashkëpunon me Drejtorinë e Auditit mbi shkeljet e konstatuara në zbatimin e buxhetit dhe vë në dijeni për masat e marra edhe institucionet e tjera me synim mospërsëritjen e shkeljeve;
- D.3. Bashkëpunon me Ministrinë e Financave për t'u njohur e përditësuar me rregullat buxhetore dhe zbatimin e tyre;
- D.4. Përfaqëson drejtorinë e përgjithshme në marrëdhënie me institucionet e tjera dhe organizata të ndryshme, me autorizim të eprorëve;
- D.5. Mban kontakte të vazhdueshme me Degën e Thesarit, bankat e nivelit të dytë, në funksion të mbarëvajtjes së menaxhimit financiar të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- D.6. Bashkëpunon dhe përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit në marrëdhënie me Departamentin e Administratës Publike (DAP) lidhur me administrimin e shërbimit civil, kur i ngarkohet nga eprori;
- D.7. Bashkëpunon dhe përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit në marrëdhënie me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), lidhur me formimin profesional të nëpunësve civilë, kur i ngarkohet nga eprori;
- D.8. Bashkëpunon me stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit lidhur me procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë etj.;
- D.9. Bashkëpunon me të gjitha strukturat në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe DSIK;
- D.10. Bashkëpunon dhe mban lidhje me Drejtorinë e Përgjithshme e Arkivave lidhur me çështjet e arkiv-protokollit.

VI

Zgjidhja e Problemeve

Zgjidh probleme lidhur me aktivitetet e përditshme që ndikojnë në arritjen e rezultateve faktike të sektorit.

VII. Vendimmarrja

Konstante, në përputhje me kuadrin ligjor, procedurat dhe standardet.

VIII. Mjedisi Menaxherial

Raporton dhe përgjigjet direkt tek Drejtori i Përgjithshëm, i cili vendos mbi çështjet procedurale të lidhura me veprimtarinë e Sektorit.

IX.

MBIKËQYRJA

Përgjegjësi i sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse merr udhëzime specifike nga Drejtori i Përgjithshëm.

X.

STAFI NËN VARËSI

Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka në varësi të drejtpërdrejtë 3 specialistë.

XI

KUSHTET E PUNËS

Realizon objektivat e pozicionit të punës në kushte të përshtatshme dhe optimale, të cilat garantojnë produktivitetin dhe realizimin e qëllimit të tij institucional. Kur është e domosdoshme mund t'i kërkojë jashtë orarit zyrtar për realizimin e detyrave urgjente.

XII

KËRKESAT E POSAÇME

(arsim/përvoja në punë /të tjera për kategorinë/klasën /grupin)

Arsimi: Të kenë diplomë të nivelit "Master shkencor apo Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike", në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;

Përvoja: Të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në profesion.

Tjetër: Njohuri të thella mbi: (i) Legjislacionin mbi buxhetin e shtetit e menaxhimin financiar, përfshirë aktet e ndryshme nënligjore e udhëzimet e Ministrisë së Financave si: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Ligji nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; (ii) ligjin nr. 152/2013 "Për Njehën Civil", Kodin e Procedurave Administrative, si dhe Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat";

Aftësi për të: Aftësi për të: (i) Integruar informacionin me objektivat buxhetore dhe politikat institucionale, (ii) aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, (iii) për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, (iv) aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre (v) Dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale. Aftësi shumë të mira analitike, përqendrim, durim, komunikim dhe fleksibilitet në punën në grupe si dhe pranim të metodave dhe procedurave të reja.

XIII

NËNSHKRIMI

Nëpunësi civil:.....Firma:

Eprori direkt:.....Firma:

Drejtori i Përgjithshëm:.....Firma:

FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË PUNËS

I

TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS

Emërtesa e pozicionit: Përgjegjës i Sektorit të Hetimit Administrativ

Institucioni: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Drejtoria: Drejtoria e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ

Sektori: Sektori i Hetimit Administrativ

Raporton tek: Drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ

II

MISIONI

Misioni i Sektorit të Hetimit Administrativ është kryerja e hetimeve administrative në institucione publike me qëllim mbështetjen e Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ në përmbushjen e objektivave të saj, në kuadër të parandalimit të korrupsionit në administratën publike, si dhe dhënia e masave dhe rekomandimeve në funksion të përmirësimit dhe standardizimit të procedurave.

III

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Përgjegjësi i Sektorit të Hetimit Administrativ përgjigjet tek Drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ për mbikëqyrjen e hetimeve administrative që kryhen nga nëpunësit e sektorit, kontrollin e veprimtarisë së koordinatorëve kundër korrupsionit, si dhe koordinimin e të gjithë informacionit për rastet korruptive të referuara nga burimet e ndryshme.

IV

DETYRAT KRYESORE

- a) Mbikëqyr kryerjen e hetimeve administrative;
- b) Kontrollon veprimtarinë e Koordinatorëve kundër korrupsionit, në përmbushje të misionit që ka Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit;
- c) Raporton mbi performancën e koordinatorëve kundër korrupsionit, mbi informacionet dhe të dhënat në fushën e antikorrupsionit, si dhe mbi çështje teknike të sektorit;
- ç) Koordinon të gjithë informacionin për rastet korruptive të referuara nga burimet e ndryshme dhe e përcjell pranë koordinatorit përkatës;
- d) Merr pjesë në hetime të thelluara në institucionet, ku shtrin veprimtarinë DPAK, sipas urdhrave të eprorëve.

V

PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. Planifikimin dhe Objektivat (nëse ka)

- A.1. Planifikon organizimin e punës, me qëllim sigurimin në kohë dhe cilësi të objektivave të miratuara;
- A.2. Harton planet e hetimit në fillim të vitit kalendarik, sipas rezultateve të analizës vjetore të punës së vitit paraardhës;
- A.3. Përgjegjës për zbatimin e planeve të hetimit të miratuara nga drejtori i përgjithshëm;
- A.4. Planifikon nevojat për trajnimet të stafit, sipas ekspertizës dhe fushës konkrete që secili mbulon dhe ja propozon kalendarin e trajnimeve eprorëve.

B. Menaxhimin (nëse ka)

- B.1. Bën shpërndarjen e detyrave dhe praktikave, në përputhje me përgjegjësitë dhe ngarkesën e çdo specialisti dhe siguron që secili i ka të qarta detyrat dhe objektivat e përcaktuara. Menaxhon punën në sektor duke shfrytëzuar burimet për arritjen e objektivave me efektivitet dhe efikasitet;
- B.2. Menaxhon marrëdhëniet e punës me kolegët e të njëjtin nivel dhe vartësit e tij;
- B.3. Përgjigjet për disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës të specialistëve të sektorit dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.
- B.4. Monitoron punën e sektorit dhe merr pjesë në vlerësimin e rezultateve në punë të specialistëve të sektorit.

C. Detyrat Teknike

- C.1. Mbikëqyr specialistët dhe i këshillon ata lidhur me rastet që u janë deleguar për trajtim;
- C.2. Ndjek punën e koordinatorit, e këshillon atë lidhur me hapat që duhet të ndërmerren prej tij në kuadër të një hetimi administrativ dhe kontrollon akt konstatimin/raportimin përfundimtar përpara se ti përcillet për vlerësim eprorëve;
- C.3. Jep kontribut të drejtpërdrejtë në hartimin e planeve të punës/hetimit, në përmbushje të misionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- C.4. Përgatit raporte informuese lidhur me çështjet teknike që mbulon drejtoria ku bën pjesë;
- C.5. Akseson sistemin elektronik të menaxhimit të denoncimeve për rekordet korruptive dhe sigurohet që të ngarkojë në sistem çdo dokumentacion ose shkresë shtesë që lidhet me ankesat/rastet e deleguara nga eprorët.

D. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin

- D.1. Përfaqëson drejtorinë e përgjithshme në grupe pune, me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm;
- D.2. Bashkërendon punën dhe mbikëqyr realizimin e bashkëpunimit midis specialistëve në varësi të tij, me kolegët brenda drejtorisë dhe me ata të drejtorisë së përgjithshme.

D.3. Ndhmon në vendosjen e bashkëpunimit midis specialistëve të drejtorisë me koordinatorët kundër korrupsionit dhe zgjidh mosmarrëveshjet e krijuara mes tyre, me qëllim mbarëvajtjen e punës.

VI

Zgjidhja e Problemeve

Zgjidh probleme lidhur me aktivitetet e përditshme që ndikojnë në arritjen e rezultateve faktike të sektorit.

VII. Vendimmarrja

Konstante, në përputhje me kuadrin ligjor, procedurat dhe standardet.

VIII. Mjedisi Menaxherial

Përgjegjësi i Sektorit të Hetimit Administrativ raporton dhe përgjigjet direkt tek Drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ, i cili vendos mbi çështjet procedurale të lidhura me veprimtarinë e sektorit. Puna në këtë pozicion ndikon në veprimtarinë e drejtorisë përkatëse.

IX.

MBIKËQYRJA

Përgjegjësi i sektorit të Hetimit Administrativ merr udhëzime specifike nga drejtori i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ dhe udhëzime të përgjithshme nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

X.

STAFI NËN VARËSI

Përgjegjësi i sektorit ka në varësi të drejtpërdrejtë 6 specialistë.

XI

KUSHTET E PUNËS

Realizon objektivat e pozicionit të punës në kushte të përshtatshme dhe optimale, të cilat garantojnë produktivitetin dhe realizimin e qëllimit të tij institucional. Kur është e domosdoshme mund t'i kërkojë jashtë orarit zyrtar për realizimin e detyrave urgjente.

XII

KËRKESAT E POSAÇME

(arsim/përvoja në punë /të tjera për kategorinë/klasën /grupin)

Arsimi: Të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite

akademike, në Shkenca Juridike/Ekonomike. Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë.

Përvoja: Të ketë 2 vite përvojë pune në profesion.

Tjetër: Njohuri dhe aftësi mbi: (i) Legjislacionin sipas veprimtarisë që mbulon drejtorin: të vendimit nr. 29, datë 17.1.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”, vendimit nr. 436, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”; Ligj Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Ligj Nr. 111/2018 “Për kadastrën”; Ligj Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligj Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligj Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (ii) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurave Administrative.

Aftësi për të: (i) aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, (ii) aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, (iii) për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, (iv) aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

XIII

NËNSHKRIMI

Nëpunësi civil:.....Firma:

Eprori direkt:.....Firma:

Drejtor i Përgjithshëm:.....Firma:

FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË PUNËS

I

TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS

Emërtesa e pozicionit: Përgjegjës i Sektorit të Komunikimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Institucioni: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Drejtoria: Drejtoria e Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit

Sektori: Sektori i Komunikimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Raporton tek: Drejtori i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit

II

MISIONI

Misioni i Sektorit të Komunikimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar është të sigurojë implementimin e **Planit Vjetor të Komunikimit dhe Vizibilitetit**, të sigurojë bashkëpunimin me organizata ndërkombëtare në fushën antikorrupsion, si dhe të realizojë fushata ndërgjegjësimi me partnerë kombëtarë ose ndërkombëtarë.

III

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

